

Instituti për Studime të Avancuara GAP

VITIA – Raporti komunal

Shtator 2009

Vitia në shifra

Popullsia	Gjithsej	63.483	
	Shqiptarë	94,7%	
	Serbë	5,1%	
	Të tjerë	0,12%	
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	297 km ²	
	Numri i fshatrave	43	
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	15%	
	Fillore/e mesme e papërfunduar	34,5%	
	E mesme	40,5%	
	Shkollë e lartë	7,3%	
	Universitet	3,4%	
	Nr. i nxënësve	13.342	
	Nr. i mësimdhënësve	627	
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	4	
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	34	
	Nr. i çerdheve	1	
	Hapësira shkollore në m ²	30.159,6	
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
		Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	6
Nr. i mjekëve		25	
Papunësia	Gjithsej	52%	
	Meshkuj	47%	
	Femra	67%	
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	38.724	
	Të punësuar në sektorin publik komunal	1.167	
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	5.634.959	
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	490.000	
	Të hyrat e tjera (Euro)	5.144.959	
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	4.531.568 (93%)	
	Shpenzimet kapitale (Euro)	377.391 (60%)	
	Shpenzimet tjera (Euro)	4.194.365 (98%)	
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	29,3%	
	LDD	21,52%	
	LDK	16,18%	
	AAK	14,57%	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

	AKR	8,92%
	PDKI	3,74%
	ORA	2,34%
	Të tjera	3,44%
Kryetarët e Komunës 2000 – 2009	2000-2002: Samet Dalipi (LDK) 2002-2007: Musa Misini (LDK) 2007-2009: Nexhmedin Arifi (PDK)	

Shkurt për Vitinë

Vitia përbën njërin nga tri komunat e rajonit të Anamorovës. Për shkak se nëpër territorin e kësaj komune kalon Morava e Binçës, dikur një lum me prurje të mëdha të ujit, popullsia e kësaj komune kryesisht janë marrë me punimin e tokës, sidomos me kultivimin e duhanit. Komuna e Vitisë përbën 2.7% të territorit të Republikës së Kosovës dhe 2.9% të numrit të gjithëmbarshtëm të popullsisë së Kosovës. Këto shifra tregojnë se Komuna e Vitisë, në krahasim me komunat tjera të Kosovës, radhitet si komunë mesatare për nga popullsia dhe shtrirja territoriale. Komuna e Vitisë dallohet për një fakt me rëndësi: në Stubëll të Vitisë është hapë shkolla e parë në gjuhën shqipe. Vitia nuk ka probleme të mëdha me mungesën e ujit të pijes, por ka një problem me kualitetin e ujit të pijes. Uji që përdoret për pije në këtë komunë shkakton dëmtime në veshkë, ku si pasojë shumë banorë të kësaj komune kanë dhimbje veshkësh. Në këtë mandat qeverisës, Komuna e Vitisë ka qenë prezent në lajmet qendrore për një fakt interesant: udhëheqja komunale e Vitisë ka kundërshtuar haptazi procesin e privatizimit, në shumë raste duke shkelur ligjet e privatizimit dhe hierarkinë e pushtetit. Në qershor 2009, Policia e Kosovës shoqëroi për në stacion policor mbi 60 zyrtarë komunal, ndër ta edhe kryetarin e komunës, pasi refuzuan të zbatonin një vendim të Gjykatës Komunale për lirimin e objektit në të cilën ishte vendosur Drejtoria e Arsimit.

Problemet aktuale

Kur përmenden problemet më të mëdha që ballafaqohet Komuna e Vitisë aktualisht, nuk mund të anashkalohej problemi i papunësisë dhe zhvillimi ekonomik, edhe pse ky problem i është problem nacional dhe jo vetëm i kësaj komune. Problemet më të mëdha të kësaj komune janë:

- Zhvillimi ekonomik/papunësia;
- Kualiteti i ujit të pijes;
- Mungesa e trotuareve për këmbësorë dhe rrjetit të kanalizimit;
- Arsimi.

Një nga problemet më të mëdha në Komunën e Vitisë është **zhvillimi ekonomik dhe papunësia**. Për shkak të pozitës gjeografike, Komuna e Vitisë njihet si komunë me potencial për zhvillimin e bujqësisë, për shkak se tokat përreth lumit “Morava e Binçës” janë toka pjellore. Mirëpo, përkundër këtij fakti, komuna nuk ka bërë mjaft deri me tani në zhvillimin e bujqësisë, dhe rrjedhimisht punësimin e qytetarëve. Sipas statistikave, fuqia punëtore në këtë komunë është 38.724. prej tyre 3% apo 1.169 veta janë të punësuar në sektorin publik (arsim, shëndetësi, administratë komunale). Në sektorin privat, biznese aktive janë 791, ku 98% e tyre janë me kapital lokal; dhe 84% e këtyre bizneseve kanë të punësuar 1-4 punonjës. Punëdhënësi më i madh në sektorin privat është Qendra Rehabilituese “Nëna Naile” (172 të punësuar), Banja e

Kllokotit (144) dhe Fabrika e Ujit "Jeta". Por, pas decentralizimit, këto tri kompani më të mëdha do të mbeten në territorin e komunës së Kllokotit. Kryetari aktual pati premtuar se "zhvillimi ekonomik do të jetë i mundur në saje të lehtësimeve të mëdha në taksë, me synimin kryesor që numri i taksapaguesve të rritet." Deri më tani nuk është vërejtur zhvillim ekonomik në këtë komunë. Komuna e Vitisë ende nuk ka një strategji për zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik.

Problemi numër dy në këtë komunë është **uji i pijes**. Edhe pse ka edhe më tutje probleme me reduktime të ujit dhe shtrirje të rrjetit të ujësllësit, problemi kryesor me ujin e pijes mbetet kualiteti i ujit. Uji i pijes në Viti shkakton probleme me veshkë. Si rrjedhojë Vitia ka një numër të madh të të sëmurëve nga veshkat. Momentalisht, në këtë komunë janë 27 pacient të cilët kanë nevojë për hemodializë, e të cilën nuk mund të kryejnë në Viti po i duhet që të udhëtojnë për në Gjilan. Komuna u ka blerë një autoambulancë për të bartur këta të sëmurë nga veshkët që kanë nevojë për hemodializë.

Edhe pse fokusi kryesor i qeverisjes aktuale lokale ka qenë përmirësimi i infsatrukturës, **infrastruktura** radhitet e treta sa i përket preokupimeve të shprehura nga qytetarët. Edhe pse ka pasur një numër të madh të investimeve në infrastrukturë, pasi që në shumë projekte ka ndihmuar edhe niveli qendror, mbetet ende shumë për tu bërë sa i përket përmirësimit të infrastrukturës. Një nga problemet më të mëdha që përmendet është mungesa e shtigjeve për këmbësorë – trotuaret. Me këtë problem më së shumti përballen banorët e fshatrave që shtrihen për skaj rrugës magjistrale Gjilan-Ferizaj. Pozhorani, si fshati më numrin më të madh të popullsisë në këtë komunë dhe i cili ka një shtrirje prej 2,5 km gjatësi dhe një popullsi prej afro 8.000 banorë, nuk ka ende trotuar. Edhe në fshatin Radivojcë mungon trotuari dhe nxënësit rrezikohen nga mungesa e trotuarit. Radivojca, ashtu sikurse edhe Pozhorani, shtrihen buzë rrugës magjistrale Gjilan – Ferizaj. I njëjti problem ekziston edhe në fshatrat Novosellë (Fshati i Ri) dhe Ramjan, pasi që nxënësit e Fshatit të Ri u duhet të kalojnë këmbë përreth magjistrals për të arritur tek shkolla në Ramjan.

Arsimi. Gjatë vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009, në Komunën e Vitisë është punuar mjaft në përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Janë ndërtuar apo janë në proces të ndërtimit katër shkolla të reja, tri me mjete të MASHT dhe një me mjete të Komunës (shkolla në Fshatin e Ri, në Viti, në Remnik dhe në Radivojcë). Mirëpo, edhe më tutje mbetet problem kualiteti i mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpër këto shkolla. Në vitin 2008, maturantët e tri shkollave të Vitisë kishin një kalueshmëri shumë të ulët në testin e maturës. E njëjta është përsëritur edhe në 2009, edhe pse vërehet një përmirësim i lehtë, por edhe ky përmirësim nuk është real pasi që besohet se këto shifra janë të fryra si pasojë e ndihmës që i është dhënë nxënësve në kalimin e testit të maturës. Në shkollën teknike në Viti, në qershor 2008 kalueshmëria ka qenë 17,27%, kurse në 2009 25%; në gjimnaz më 2008 kalueshmëria po ashtu ka qenë 17%, kurse në qershor 2009 ka qenë 59%. Përveç shkallës së ulët të kalueshmërisë së maturantëve, problem mbetet edhe angazhimi profesional i mësimdhënësve dhe kualiteti i mësimdhënies. Qytetarët nuk i besojnë aspak konkursit të komunës për përzgjedhjen e personelit arsimor pasi që besojnë se ai është i manipuluar dhe shërben për punësimin e kadrove të partisë në pushtet. Brengosëse është edhe mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive në këtë komunë. Biblioteka e qytetit ka një lexueshmëri të paktë, si pasojë e menaxhimit të dobët dhe mungesës së titujve të rinj për t'u lexuar.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në zgjedhjet lokale të vitit 2007, Kryetar Komune u zgjodh Nexhmedin Arifi. Nexhmedin Arifi fitoi **3.353 vota** apo **23,63% të votave** në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 dhe në këtë mënyrë ai fitoi të drejtën që ta vazhdojë garën në zgjedhjet e balotazhit tri javë më vonë. Në balotazh për kundërkandidat e kishte Sokol Halitin nga LDD. Nexhmedin Arifi mori **6.092 vota** apo **52,4%** dhe fitoi të drejtën për të qeverisur me komunën për dy vitet në vazhdim. Zgjedhjet në Komunën e Vitisë janë karakterizuar me manipulim të madh të votave, ku si rezultat nga KQZ janë anuluar votimet në disa qendra të votimi të kësaj komune.

Sa i përket premtimeve të dhëna në fushatën parazgjedhore, Nexhmedin Arifi ka arritur t'i plotësojë vetëm pjesërisht. Gjatë 2008 dhe 2009 në Komunën e Vitisë ka pasur një numër të madh investimesh me mjetet të komunës dhe me participim të nivelit qendror, meqë rast ka pasur investime në rrugë, shkolla dhe shëndetësi. Nexhmedin Arifi pati premtuar se duke ulur taksat për bizneset komunale do të ndikoj në rritjen e punësimit dhe zhvillimit ekonomik. Mirëpo asgjë nuk është arritur në këtë drejtim. Problemi numër një i qytetarëve të kësaj komune edhe më tutje mbetet papunësia dhe zhvillimi ekonomik, kurse taksat për biznese ende nuk janë ulur pasi që kjo komunë edhe më tutje çështjen e taksave e ka të rregulluar me një rregullore komunale të miratuar gjatë mandatit të kaluar qeverisës.

As premtimi për bërjen e punës së Asamblesë Komunale më transparente dhe më të hapur për qasje e qytetarëve nuk është përmbushur. Qeverisja aktuale e komunës është treguar mos bashkëpunuese me iniciativat qytetare dhe organizatat e shoqërisë civile.

Tab. 1. Premtimet dhe realizimi i tyre

Premtimet	Realizimi i premtimeve
Asambleja Komunale do të jetë e hapur për qytetarë dhe do t'u kthehet qytetarëve.	Në përgjithësi pushteti aktual i Vitisë është jo transparent sipas vlerësimeve të qytetarëve, edhe pse mbledhjet e Kuvendit Komunal transmetohen në TV Iliria, pasi që komuna ka një kontratë me këtë medium lokal.
Ndarja e buxhetit komunal do të bëhet në bazë të prioriteteve. Buxheti do të harxhohet në infrastrukturë rrugore, në kanalizim, në ujësjellës, arsim, shëndetësi. Do të bëhet kursim në shpenzime, mallra dhe derivate.	Si në çdo mandat tjetër qeverisës në këtë komunë, edhe në këtë mandat buxheti është shpenzuar në infrastrukturë rrugore, kanalizim, ujësjellës, arsim, shëndetësi. Vetëm se në këtë mandat, si pasojë edhe e ndihmës së nivelit qendror, është investuar më shumë në këtë drejtim. Gjithashtu, në krahasim me qeverisjen e kaluar e cila ka shpenzuar shumë më shumë në mallra dhe derivate, kjo qeverisje gjatë vitit 2008 ka aplikuar një ulje të shpenzimeve.
Do të ndërtohen shkolla të reja, si për shembull shkolla në Sllatinë të Epërme dhe në Radivojcë; shkollat e filluara do të përfundohen.	Është ndërtuar shkolla në Sllatinë të Epërme dhe në Radivojcë; gjithashtu me ndihmën e MASHT është ndërtuar edhe shkolla në Remnik dhe Viti. Megjithëse shkolla në Remnik është filluar më shumë se një vit më parë, kjo shkollë nuk është bërë gati për të pranuar nxënësit në fillim të shtatorit 2009
Përmes përmirësimit të menaxhimit në	Përmirësimet e vetme që përmenden në

Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë, do të përmirësohen kushtet në sektorin e shëndetësisë primare në Viti.	shëndetësinë komunale janë furnizimi i rregullt i QKMF-së me rrymë dhe sigurimi i një automjeti për bartjen e pacientëve që kanë nevojë për hemodializë në spitalin e Gjilanit. Kurse sa i përket menaxhmentit është ndërruar drejtoresha e Shtëpisë së Shëndetit znj. Gjylsime Qamili, e cila kishte kontratë deri në mars të vitit 2009 dhe zëvendësuar me z. Nazim Dauti nga PDK.
Zhvillimi ekonomik do të jetë i mundur në sajë të lehtësimeve të mëdha në taksa, me synimin kryesor që numri i taksapaguesve të rritet	Nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Zhvillimi ekonomik dhe papunësia mbeten problemi numër një në këtë komunë, kurse komuna nuk ka bërë asgjë në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi. Nuk janë ulur taksat. Komuna ende vepron me Rregulloren Komunale për taksa, Ngarkesa dhe gjoba e cila është miratuar në 2007 kur kryetar ka qenë Musa Misini (LDK).

Zgjedhjet lokale në Viti

Me mbarimin e luftës në qershor 1999 e deri në zgjedhjet e para lokale në vjeshtë 2000, kryetar i komunës së Vitisë ishte emëruar Daut Xhemajli, i cili tani mban postin e kryetarit të degës së PDK në këtë komunë dhe shef i Administratës Publike në qeverisjen e PDK. Zgjedhjet e para lokale në këtë komunë i fitoi kandidati i LDK Samet Dalipi i cili ushtroi detyrën e kryetarit të Kuvendit Komunal në vitet 2000-2002. Edhe zgjedhjet lokale të 2002 i fitoi LDK, por kësaj radhe me një kandidat tjetër – Musa Misinin. Pas shtatë viteve të qeverisjes së LDK me dy kryetar të ndryshëm, zgjedhjet e vitit 2007 në këtë komunë i fitoi PDK. PDK fitoi shumicën e ulëseve në KK, edhe pse pati një rënie të numrit të votave ku më 2007 mori 1063 vota më pak se sa në zgjedhjet e 2002, por arriti të mbaj numrin e njëjtë të ulëseve në KK falë edhe ndarjes së LDK dhe formimit të LDD, por edhe formimit të partive tjera. Rënien më të madhe të votave ka pësuar LDK, e cila që nga zgjedhjet e para lokale më 2000 ka humbur 8570 vota. Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale, në komunën e Vitisë kanë konkurruar 19 parti të ndryshme për të zënë vend në Kuvendin Komunal 31 anëtarësh. Por, në tri legjislaturat e gjertanishme, vetëm 11 parti kanë arritur, që të fitojnë vota të mjaftueshme për të hyrë në Kuvendin Komunal; kurse vetëm tri parti (LDK, PDK dhe AAK) kanë arritur të fitojnë vend në KK vazhdimisht në tri mandate. Pas zgjedhjeve të 15 nëntorit 2009, Kuvendi Komunal nuk do të ketë më 31 anëtarë por vetëm 27.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Vitisë.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	4631	8	5127	9	4064	9
LDK	10814	19	9394	17	2244	5
AAK	912	2	1169	2	2021	5
LDD	-	-	-	-	2985	7
AKR	-	-	-	-	1237	3
PDKI	-	-	-	-	519	1
ORA	-	-	-	-	325	1
PSHDK	499	1	603	1	-	-

"Povratak"	-	-	358	1	-	-
IQV	-	-	613	1	-	-
PLK	412	1	-	-	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 68,5%, dy vite më vonë ajo ra në 47.9%, kurse për vitin 2007 nuk ka të dhëna të plota, edhe pse besojmë ky trend ka vazhduar. Në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009, të drejtë vote kanë 41.444 qytetarë, kurse për komunën e re të Kllokotit, e cila shkëputet nga Komuna e Vitisë, të drejtë vote kanë 2.706 qytetarë. Kuvendi Komunal i Kllokotit do të ketë 15 anëtarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Viti në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	27.462	38.085	?
Vota valide	18.109	17.991	13.872
Përqindja e daljes në votime	68,5%	47,9%	

Buxheti i Komunës

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Vitisë ka shkuar gjithnjë duke u rritur, përveç në vitin 2005, ku ka shënuar rënie. Buxheti ka shënuar rritje të ngadalshme, sidomos në periudhën 2003-2008, ku për gjashtë vite buxheti është shtuar vetëm për 776.543 Euro. Një rritje më e madhe e buxhetit është vërejtur në vitin 2009, ku buxheti është rritur për 1.206.634 Euro. Edhe pse buxheti ka pasur një rritje të ngadalshme por të vazhdueshme, investimet kapitale nuk kanë shkuar duke u rritur por për katër vite këto investime kanë shënuar rënie, kurse shpenzimet për rroga kanë shkuar duke u rritur nga viti në vit.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rroga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Rezerva	Gjithsej
2009	3.682.394	504.388	201.806	62.000	1.184.371	-	5.634.959
2008	3.100.071	596.183	201.806	62.000	468.265	-	4.428.325
2007	2.994.013	524.343	151.599	82.277	605.110	-	4.357.342
2006	2.935.703	563.840	121.041	68.674	607.214	-	4.296.472
2005	2.871.951	504.691	98.805	82.900	643.197	-	4.201.544
2004	2.919.718	778.368	-	-	622.398	39.506	4.359.990
2003	2.169.643	742.987	-	-	739.152	-	3.651.782

Për vitin 2009, buxheti i Vitisë është paraparë të jetë 5.634.959 Euro, prej të cilave vetëm 8,6% janë të hyra vetanake të komunës. Të hyrat vetanake të planifikuara në fillim të vitit prej 490.000 Euro, janë të hyrat më të mëdha që ka planifikuar kjo komunë; kurse viti 2008 ka shënuar rritjen më të madhe të arkëtimit të të hyrave vetanake të komunës – me 524.000 Euro. (në vitin 2007 të hyrat vetanake ishin 350.000 euro; në 2006 – 354.000 Euro; në 2005 – 469.000 Euro; në 2004 – 418.760 Euro, etj.).

Sipas projekteve buxhetore, buxheti i Komunës së Vitisë nuk parashihet që të jetë më i madh as në dy vitet në vazhdim; për vitin 2010 buxheti do të jetë 5.393.410 €, kurse në 2011 do të jetë 5.542.500 €.

Investimet kapitale

Nëse nuk llogarisim vitin 2009, Komuna e Vitisë deri në 2008 ka pasur një mesatare prej 600.000 € për investime kapitale për vit. Kjo shifër është rritur më shumë në 2009 dhe kaq shumë prej 1.184.371 €. As në vitet në vazhdim nuk parashihet rritje e madhe e buxhetit për investime kapitale. Sipas paralogaritjeve buxhetore që i ka bërë komuna, buxheti ndarë për investime kapitale në këtë vit dhe për tri vitet në vazhdim është sipas tabelës më poshtë:

Tab.5. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Vitisë

Buxheti	2009	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	5,634,959	6,251,906	6,406,734	6,627,046
Të hyrat vetanake në €	490,000	661,128	682,116	701,792
Investimet kapitale në €	1,184,371	1,495,022	1,693,350	1,964,652

Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Vitisë do të ketë në dispozicion **5.1 milion €** për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Vitisë për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se **7 milion €** për investime kapitale.

Gjatë vitit 2008 janë kryer një numër i konsiderueshëm i investimeve kapitale. Projektet më me rëndësi për komunën në të cilat janë financuar nga buxheti i komunës janë:

Tab.6. Investimet më të rëndësishme kapitale

Emri i projektit	Shuma e shpenzuar nga buxheti komunal
Asfaltimi i rrugës Viti – Beguncë	50.000 €
Asfaltimi i rrugës Tërpezë – Pozhoran	41.000 €
Rregullimi i rrjetit elektrik për shtëpinë e shëndetit (QKMF)	24.870 €
Ndërtimi i shkollës në Fshatin e Ri (Novosellë)	96.884 €

Kurse për vitin 2009 janë paraparë që të investohet në këto projekte: ndërtimi i shkollës fillore në Ramnisht (123.138 €), rregullimi i trotuareve dhe drurëve dekorues (136.000 €), rregullimi i varrezave të dëshmorëve (56.431 €), projekte të tjera më të vogla dhe projekte me bashkëpjesëmarrje me nivelin qendror dhe donatorët.

Administrata komunale

Në sektorin publik në komunën e Vitisë në vitin 2009 janë të punësuar 1167 veta, në administratë, shëndetësi dhe arsim. Ky numër i të punësuarve në këtë sektor ka shkuar duke u zvogëluar nga viti në vit, siç tregon tabela e mëposhtme:

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Vitisë sipas viteve

Viti	Numri total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	1167
2008	1169
2007	1197
2006	1201
2005	1200
2004	1235
2003	1146

Ndryshimet në numrin e të punësuarve në sektorin publik komunal janë ndikuar nga lëvizjet e numrit të punëtorëve në administratën komunale. Në 2009, në administratën komunale të Vitisë janë të punësuar 168 punonjës. Sipas vendimit 10/46 të Qeverisë së Kosovës të dhjetorit 2008, Komuna e Vitisë ka të punësuar në administratën komunale 8 punonjës më shumë se që është e lejuar me këtë vendim.

Komuna e Vitisë dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale dhe marrëdhëniet e komunës me nivelin qendror, Komuna e Vitisë në masë të madhe i ka përmbushur obligimet ligjore. Kuvendi Komunal i Vitisë ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta, ashtu siç parashihet edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Por, Komiteti për Buxhet dhe Financa (KPF) i cili është komitet obligativ dhe detyrat e tij janë ndër të tjera edhe rekomandimi i rendit të ditës për Kuvendin Komunal, është takuar vetëm 6 herë gjatë tërë vitit 2008. Ky fakt tregon se jo gjithëherë Kuvendi Komunal ka mbajtur seanca sipas rendit të ditës të caktuar në KPF. Përveç kësaj, komuna e Vitisë është njëra nga gjashtë komunat e cila nuk i dërgon ftesat për mbledhjet e KK edhe në Ministrinë e Pushtetit Lokal, ashtu siç kërkohet me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarë, Vitia gjatë tërë vitit 2008 ka mbajtur dy tubime, aq sa kërkohen edhe me ligj. Mirëpo pjesëmarrja e qytetarëve në këto tubime publike nuk ka qenë e kënaqshme. Gjatë vitit 2009, sipas zyrtarëve të Zyrës për Informim të kësaj komune, kryetari ka mbajtur takime të shpeshta me qytetarë si në qytet ashtu edhe në komuna, por jo në të gjitha këto takime është njoftuar zyra për informim dhe ftesat e lajmërimit nuk kanë shkuar përmes kësaj zyreje. Andaj kjo zyre nuk ka një numër të saktë të këtyre tubimeve jo formale.

Gjatë vitit 2008 në zyrën e arkivit të Komunës së Vitisë është dorëzuar vetëm një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare e cila ka marrë përgjigje pozitive; kurse gjatë vitit 2009 është dorëzuar po ashtu vetëm një kërkesë (deri në fund të shtatorit). Nuk është dorëzuar asnjë peticion gjatë 2008, kurse gjatë 2009 është vetëm një.

Komuna e Vitisë ka hapur faqen e saj të internetit në fund të vitit 2008. Sa i përket kategorive, informacione, dokumenteve, dhe të dhënave tjera që janë plasuar në këtë uebfaqe, del se përmbajtja e uebfaqes është në nivel të kënaqshëm.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Vitisë (www.komunaevitise.org)

Kategoritë informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	4
Organizimi komunal	3.3
Shërbimet komunale	2.6
Info rreth qytetit	2.5
Projektet komunale	3
Lajme & lajmërimet	4.3
Harta e faqes	1
Kontakt	3
Gjuhët	2
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	2
Mesatarja totale	2.9
Rangimi në krahasim me uebfaqet e komunave tjera	15

Gjendja në arsim

Një nga problemet më të mëdha të kësaj komune mbetet niveli dhe kualiteti i sistemit arsimor. Për këtë problematikë kemi shkruar më shumë në pjesën e mësipërme ku arsimi paraqet njërin nga pesë problemet kryesore të komunës. Edhe pse komuna në bashkëpunim me nivelin qendror kanë investuar mjaft në infrastrukturën shkollore gjatë këtyre dy viteve, mbetet ende shumë për tu bërë në përmirësimin e mëtutjeshëm të hapësirës shkollore, e mbi të gjitha në kualitetin e mësimdhënësve. Në tërësi komunën e Vitisë funksionojnë 39 institucione shkollore së bashku me paralelet: një çerdhe, katër shkolla të mesme, 34 filllore. Vitia nuk ka asnjë institucion të arsimit special. Hapësira shkollore në tërësi është 30.159.6 m³. Numri i mësimdhënësve është 694 (34% e mësimdhënësve janë femra). Numri i nxënësve në të gjitha nivelet është 13.272. Në të ardhmen, krahas investimeve në infrastrukturën shkollore, menaxhmenti i komunës në këtë sektor duhet të mendojë edhe për rritjen e kualitetit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Gjendja në shëndetësi

Komuna e Vitisë ka një Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe 12 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe punkte shëndetësore. Numri i mjekëve në këtë komunë është 25. Një nga problemet më të mëdha shëndetësore me të cilat

² (radhitja nga 1 deri 5) 5-shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

përballen qytetarët e kësaj komune janë sëmundjet e veshkave, si pasojë e kualitetit jo të mirë të ujit të pijes. 27 pacientë nga kjo komunë kryejnë hemodializën në spitalin regional të Gjilanit. Komuna ka arritur të siguroj një kombi-bus për bartjen e tyre deri në spitalin e Gjilanit. Qytetarët përveç në spitalin e Gjilanit, mund të drejtohen edhe në atë të Ferizajt, të cilët për nga largësia janë pothuajse në distancë të njejtë. Gjatë kësaj qeverisjeje (2007-2009), përveç blerjes së automjetit për bartjen e pacientëve për hemodializë, komuna ka siguruar furnizim të pandërprerë me rrymë për QKMF, 9.000€ janë ndarë në 2008 për renovim të ambulantave, kurse 30.000€ në 2009 për blerje të mjeteve shëndetësore.

Shoqëria civile

Në komunën e Vitisë, ekzistojnë tri organizata jo qeveritare më aktive: “Elita”, Shoqata e Femrave “Legjenda” dhe grupi i të rinjve “Aster”. “Elita” është organizatë jo qeveritare që funksionon që nga pas lufta dhe aktivitetet e saj janë të larmishme, duke filluar nga avokimi për transparencë, monitorimi i punës së KK, projekte të ndryshme në komunitet, etj. “Legjenda” funksionon që nga viti 1995 dhe ky grup e konsideron veten si OJQ e dytë me e vjetër në Kosovë. Aktivitetet e kësaj organizate kanë qenë të ndërlidhura edhe me pushtetin komunal, por fokusi më i madh i kësaj organizate ka qenë trajnimi i femrave në kurse kompjuterike dhe rrobaqepësi.

Mediat lokale

Në Komunën e Vitisë, funksionojnë tri radio lokale dhe një televizion: Radio dhe TV “Iliria”, Radio “Zëri i Pozhoranit” dhe Radio “Klllokoti”. Radio “Klllokoti” është radio me udhëheqje dhe program në gjuhën serbe dhe nuk është e kyçur në jetën publike të komunës së Vitisë. Kjo radio tani ka filluar me një seri të debatesh për nevojën e decentralizimit në këtë komunë – formimin e Komunës së re të Klllokotit. Radio “Zëri i Pozhoranit” nuk është shumë aktive në ndjekjen e punimeve të trupave komunale apo në informimin e qytetarëve me problemet e komunës. Ky medium në bashkëpunim me OJQ “Elita” tani kanë filluar një seri debatesh për punën e komunës, ku drejtorët e drejtorive japin raportet për punën e tyre në komunë. Radio dhe TV “Iliria”, dy medime me një pronar të përbashkët, janë më aktive sa i përket përcjelljes së punimeve të KK dhe aktiviteteve të komunës. Ndoshta kjo është edhe si pasojë e asaj se ky medium ka një kontratë me komunën për transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit Komunal. Këto medime kohëve të fundit janë duke u përballur me probleme të mëdha financiare, si pasojë e mungesës së reklamave. Deri në vitin e kaluar, KFOR-i amerikan ka qenë mbështetësi më i madh financiar për këto medium, mirëpo tani edhe KFOR ka ndërprerë apo zvogëluar ndihmën financiare.

Rendi dhe ligji në Komunën e Vitisë

Për nga numri i popullsisë, Komuna e Vitisë radhitet e 16 në krahasim me komunat tjera të Kosovës. Sa i përket rasteve të shkeljes së rendit dhe ligjit të evidentuara nga Stacioni Policor i Vitisë, me **1169 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit** për gjatë tërë vitit 2008, Vitia radhitet në vendin e 17. Shkeljet e rendit dhe ligjit kanë ndodhur në 68 fusha të ndryshme. Disa nga llojet e shkeljeve të ndodhura në Komunën e Vitisë janë të radhitura më poshtë:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Viti (2008)

Lloji i shkeljes	Numri i rasteve	Radhitja në krahasim me komunat e tjera për numrin e rasteve
Aksidente	262	11
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	71	17
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	13	21
Vjedhje e pyjeve	1	21
Incidente lidhur me pronën	70	12
Vjedhje	313	11
Abuzime seksuale	9	8
Shkaktim të dëmtimeve trupore	101	9
Kërcënime	55	10
Mashtrime	14	13
Vrasje	4	16

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullore së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimore të tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje të UNMIK-ut, Kuvendi Komunal i Vitisë ka adaptuar në tetor 2008 Rregulloren Komunale për Caktimin dhe Aplikimin e Tatimit në Pronë në Komunën e Vitisë për 2009. Sipas kësaj rregulloreje, Komuna e Vitisë është ndarë në katër zona kadastrale, të cilat edhe kanë vlera të ndryshme të tregut. Tabela më poshtë paraqet llojet e pronës, normat tatimore dhe çmimin e tregut për atë pronë.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Vitisë

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
Norma tatimore					
	0,13%	0,13%	0,17%	0,14%	0,10%
I	390 €	240 €	600	450	100
II	350 €	200 €	450	400	80
III	/	150 €	350	350	60
IV	/	100 €	300	200	40

Kostoja për biznese

Në komunën e Vitisë janë të regjistruara 1651 biznese. Por vetëm 784 janë aktive. Bizneset aktive janë kryesisht tregtare. Në bazë të Rregullore së Komunës së Vitisë

për taksa, ngarkesa dhe gjoba, Komuna ka përcaktuar nivelin e pagesës për funksionimin e çdo lloji të biznesit në komunë. Tabela më poshtë paraqet disa nga llojet e bizneseve më të shpeshta dhe pagesën vjetore për leje të punës në territorin e Komunës së Vitisë. Pagesa dallon në bazë të zonave, ku zonat në viti janë të ndara në katër shkallë që dallojnë sipas pagesës për biznese, tatim në pronë dhe leje ndërtimore.

Tab.9. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	350 €
Kompanitë e sigurimit	350 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	350 €
Agjensionet turistike	150 €
Hotelet	280 €
Motelet	155 €
Supermarketet – Hipermarketet	200 €
Vetëshërbimet – Minimarketet	100 – 140 €
Kafiteritë	105 €
Restorant	125 €
Shitoret	50 – 100 €
Tregtia lëvizëse	30-50 €
Libraritë	80 €
Kioskat	20-30 €
Depot	120-200 €
Barnatoret (Farmacitë)	120 €
Autoshkollat	70 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	30 – 130 €
Ndërmarrjet (ndërtimore, industriale, etj.)	100 – 200 €
Pompat e benzinës	210 – 280 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	50 - 120 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.